



Drejtoresha Ekzekutive e AKD-së, znj. Sonila Hysi takim me Ambasadoren e Republikës së Shqipërisë në Greqi, Znj. Luella Hajdaraga



Drejtoresha Ekzekutive, Znj. Sonila Hysi dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës zhvilluan sot një takim me Ambasadoren e Republikës së Shqipërisë në Greqi, Znj. Luella Hajdaraga, Oficeren Koordinuese për Diasporën znj. Joneda Dodaj dhe Ministër Këshilltar znj. Eliverta Rodomi, në kuadër të programit “Ditët e Shqipërisë”, program i krijuar për komunitetin shqiptar në Greqi.

Znj. Hajdaraga mbështeti nismat e AKD-së dhe bashkë me drejtoreshën ekzekutive diskutuan mbi nisma dhe projekte të përbashkëta për tu zhvilluar në të ardhmen. AKD dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë do të mirëpresin në takime në datat 5, 6 dhe 7 tetor shoqatat e komunitetit shqiptar në Greqi si dhe ka organizuar një shfaqje artistike për ta me artistët e Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

AKD bën bashkë shqiptarët në Greqi: Takim me shoqatat, në fokus fuqizimi i diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës mbledh të gjitha shoqatat në Greqi duke diskutuar mbi programe dhe projekte të përbashkëta që fuqizojnë rolin e diasporës shqiptare në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendit, si dhe duke dëgjuar nga afër problematikat dhe kërkesat e të gjitha shoqatave të pranishme.

Shqiptarë të diasporës në Greqi kanë ardhur nga Athina dhe gjithë Greqia e Jugut për të ndjekur aktivitetin tri ditor “Ditët e Shqipërisë” të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës me qëllim njohjen me komunitetin shqiptar në Greqi, krijimin dhe zhvillimin e urave të bashkëpunimit me ta por edhe përcimin e traditës dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet aktivitetit artistik dhe programit kulturor të ofruar.



Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

AKD takim me organizata dhe komunitetin e grave të Diasporës shqiptare në Greqi



Ditët e mërkurë është zhvilluar takimi i parë në formë bashkëbisedimi zyrtar mes Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatave Shqiptare në Greqi, për të insitucionalizuar bashkëpunimin tripalësh në të ardhmen, në dobi të komunitetit shqiptar.

Me qëllim fuqizimin e rolit të Diasporës në Greqi, si një nga komunitetet më të mëdha shqiptare që jetojnë jashtë, Ambasadorja, znj. Luella Hajdaraga dhe Drejtoresha Ekzekutive e AKD-së, znj. Sonila Hysi, informuan se, do të realizohen programe dhe projekte të përbashkëta në fushën ekonomike dhe kulturore duke rritur kështu ndikimin ekonomik, kulturor pse jo edhe politik të komunitetit në jetën sociale të Greqisë.

Duke u ndalur tek impakti i aktivitetit “Ditët e Shqipërisë” bashkëbiseduesit ranë dakort se aktiviteti do të ndihmojë në njohjen e institucioneve shqiptare me komunitetin, krijimin dhe zhvillimin e urave të bashkëpunimit, por edhe në përcimin e traditës dhe trashëgimisë kulturore nëpërmjet aktivitetit artistik dhe programit kulturor të ofruar.

CONNECT ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

Koncerti me artistët e Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore në skenën e Teatrit “Katina Paxinou” në Attiko Alsos, Athinë



RRJETI I PROFESIONISTËVE TË DIASPORËS

rrjetiiprofesionistevetediaporës.al

Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

AKD sjell në Ambasadën e Shqipërisë në Athinë panairin e librit, workshopin e valleve dhe këngëve dhe ekspozitën e veshjeve tradicionale

